



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 3.5.2023

Nr: 434

Ora: 16:00

**VENDIM**

**PËR**

**NXJERRJEN JASHTË PËRDORIMIT TË VULËS SË KZAZ-SË NR. 41, QARKU TIRANË DHE**  
**ZËVENDËSIMIN ME VULË REZERVË**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “n”, dhe 2, nenit 103, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 14 pika 2, shkronja “k”, të vendimit nr. 5, datë 20.11.2020 të Komisionit Rregullator “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

**V Ë R E N:**

Në referim të nenit 14, pika 2, shkronja “k” të vendimit nr. 5, datë 20.11.2020 të Komisionit Rregullator “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor”, përcaktohet se sekretari i KZAZ-së është përgjegjës për administrimin dhe përdorimin e vulës së KZAZ-së dhe njoftimin e menjëhershëm të rasteve të dëmtimit apo të humbjes së vulës së KZAZ-së.

KZAZ-ja nr. 41, Qarku Tiranë, me shkresën nr. 4531 prot, datë 03.05.2023, informon Komisionin Qendror Zgjedhjeve për humbjen e vulës, rrethanat, si dhe kërkon pajisjen me vulë rezervë. Bazuar në informacionin e KZAZ-së nr. 41 nënshkruar nga pesë anëtarët, Nënkryetari, Kryetari dhe Sekretari, në datën 02.05.2023, nga ana e KZAZ nr. 41 u raportua se ka humbur vula.

Në këto kushte, KZAZ nr. 41 kërkon nxjerrjen jashtë përdorimit të vulës së humbur dhe pajisjen me vulë rezervë.

**PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “n”, dhe 2, nenin 103, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenin 14 pika 2, shkronja “k”, të vendimit nr. 5, datë 20.11.2020 të Komisionit Rregullator “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor”,

Data: 3.5.2023 Nr: 434  
Ora: 16:00



“Për nxjerrjen jashtë përdorimit të vulës të KZAZ-së nr. 41, Qarku Tiranë dhe zëvendësimin e saj me vulë rezervë”

## V E N D O S:

1. Nxjerrjen jashtë përdorimit të vulës së KZAZ-së nr. 41, Qarku Tiranë, e prodhuar sipas modelit të vendimit nr. 7, datë 9.1.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
2. Zëvendësimin e vulës së KZAZ-së nr. 41, Qarku Tiranë, me vulë rezervë sipas modelit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

Zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023

Formati i Vulës: KZAZ - REZERVË



**Legjenda:**

1. Diametri = 38 mm
2. Stema e Republikës së Shqipërisë
3. Tekst: Republika e Shqipërisë
4. Tekst: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
5. Numri i identifikimit, tekst: KZAZ-R-41
6. Tekst: Zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023